VENDIM
Nr. 36 datë 25.1.1993

PËR PËRBALLIMIN NGA BUXHETI I SHTETIT TË SHPENZIMEVE PËR MËNJANIMIN E PASOJAVE TË PËRMBYTJES (FAZA E DYTË)

Me propozimin e Komisionit qëndror për mënjanimin e pasojave të përmbytjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 1993:

- Shpenzimet për rimbjelljen e sipërfaqes së përmbytur e të dëmtuar të grurit për 32,7 milionë lekë.
- Punimet për vënien në shfrytëzim të hidrovoreve, digave dhe argjinaturave me një fond prej 245 milionë lekësh.
- Punimet për vënien në shfrytëzim të industrisë së bakrit me një fond prej 78 milionë lekësh.
- Punimet për vënien në shfrytëzim të rrjetit elektrik dhe hidrocentralit me një fond prej 40 milionë lekësh.
- Shpenzimet e bëra për ndihmat ushqimore të shpërndara në zonat e përmbytura nga Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë me një fond prej 3,4 milionë lekësh.
- Shpenzimet për meremetimet e rrjetit rrugor automobilistik e të linjave hekurudhore Milot-Rrëshen e Milot-Hani i Hotit dhe për parqet automobilistike të mallrave Laç e Rrëshen me një vleftë prej 125.7 milionë lekësh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi